



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KABINETI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2011

Lënda : Mbi rishikimin e PBA 2010-2011 dhe realizimin e treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2010.

Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJTHSHME TË BUXHETIT

Në zbatim të Ligjit Nr.9936 date 26.6.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" dhe ", Ligjit Nr.10190 date 26.11.2009 "Per buxhetin e vitit 2010", ne zbatim te Udhezimit Nr. 1 date 21.1.2010 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010" si dhe ne pergjigje te shkreses tuaj Nr.340 date 11.1.2011 bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për rishikimin e PBA 2010-2011 si dhe treguesit e monitorimit per realizimin e buxhetit viti 2010.

Ne vijim te sa me siper Ministria e Shendetesise ne perputhje me planin e rishikuar pas aktit normativ ka kryer perocetin e Rishikimit te Shpenzimeve te Programit per vitin 2010 dhe per vitin 2011. Te dhena te cilat te gjitha jane hedhur ne softin e PBA-se.

Bashkelidhur gjeni RPP dhe PSHP per vitin 2011, ndersa te dhenat e vitit 2010 nuk jane printuar nga softi per arsye se tavanet e hedhura per investimet nuk ishin te detajuar vec per artikullin 230 dhe vec per artikullin 231. Sidoqofte te dhenat e tjera jane hedhur ne soft.

Bashkelidhur gjithashtu gjeni edhe raportet e monitorimit financiar per vitin 2010.

Ne total realizimi buxhetit per vitin 2010 eshte 96.7%.

Realizimi i i fondit te pagave eshte 92%, i sigurimeve shoqerore e shendetesore eshte 98%.

Realizimi i shpenzimeve operative eshte 90%.

Realizimi i investimeve nga buxheti i shtetit eshte ne masen 96%.

Sipas programeve buxhetore realizimi i investimeve paraqitet si vijon:

Ne 000/leke

PROGRAME BUXHETORE	Plani inv.brend v.2010	Realizimi inv.brendshme v.2010	% e realizimit te fin.brendsh

01110	43.968	40.630	92%
07220	215.867	207.945	96%
07330	1.302.331	1.259.843	97%
07450	19.050	11.216	59%
Totali	1.581.216	1.519.635	96%

- Programi Planifikim Menaxhim Administrim

Plani per kete program eshte 43.968 mije leke, realizimi 40.630 mije leke ose baraz me 92%. Diferenca e pafinancuar prej 2.309mije leke, ka te beje me diferencen midis fondit limit te celur dhe atij te kontraktuar. Ndersa dy objekte investimi me vlere totale 1.029mije leke po ne kete program, nuk u arriten te realizoheshin(procedurat e tyre).

- Programi Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor

Plani eshte 215.867 mije leke ndersa financimi eshte 207.945 mije leke baraz me 96%. Ne kete program nje vlere te konsiderueshme ka zene zeri "TVSH+Kosto Lokale" per projektet me financim te huaj dhe perkatesisht 135.590mije leke ose ndryshe 63% te planit te programit te kujdesit shendetesor paresor, ndersa financimi i ketij zeri ka gene ne vleren 131.501mije leke baraz me 97%. Diferenca e pafinancuar prej 7.920mije leke, ka te beje me diferencen midis fondit limit te celur dhe atij te kontraktuar.

- Programi Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor

Plani ne total per kete program eshte 1.302.331 mije leke, ndersa financimi eshte 1.259.843mije leke, ose baraz me 97%. Ashtu si ne programin e kujdesit paresor, edhe ne kete program vlere te konsiderueshme kundrejt fondit te buxhetit te brendshem(07330) e ze zeri « TVSH+kosto Lokale » per objektet me financim te huaj dhe perkatesisht me vlere 482.350mije leke, ose ndryshe 37% te planit te programit te kujdesit shendetesor paresor ndersa financimi eshte ne vleren 471.284mije leke ose baraz me 98%. Paralelisht me zerin e lartepemendur , ministria e shendetesise ka pasur prioritet ne kete program pajisjen e spitaleve rajonale kryesisht, por duke mos lene pas dore dhe ato te distrikteve, me aparatura mjekesore bashkekohore dhe kjo duket nga vlere qe ky ze ka pasur kundrejt planit te buxhetit vjetor per kete program dhe perkatesisht 507.130mije leke, ose ndryshe 39%, ndersa financimi ka qene ne vleren 494.470mije leke ose ne masen 97%. Diferenca e pafinancuar prej 31.048mije leke, ka te beje me diferencen midis fondit limit te celur dhe atij te kontraktuar, ndersa vetem 11.440 mije leke ose 1% e fondit te celur v.2010 per programin e kujdesit dytesor ka te beje me objekte qe nuk munden te realizoheshin si procedura.

Programi Sherbime te Shendetit Publik

Plani eshte 19.050 mije leke ndersa financimi eshte 11.216 mije leke, baraz me 59%. Ne kete realizim te ulet ka ndikuar pezullimi i procedurave te prokurimit per disa objekte qe kapin vleren 5.535mije leke ose ne masen 29% kundrejt fondit total te ketij programi. Ndersa vlera tjetere prej 2.298mije leke ose ne masen 12% kundrejt fondit total te ketij programi, paraqet diferencen midis fondit te celur dhe atij te prokuruar dhe te kontraktuar njekoheisht.

Te gjitha raportet e monitorimit vjetore jane publikuar ne faqen tone te internetit ne rubriken monitorimi financiar.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARE E PERGJITHSHME

MIRELA CANO

Mbi gjendjen e zbatimit të projeteve me financim të huaj.

I. Projekti i Ndërtimit të Spitalit të Semundjeve të brendshme QSU Tiranë(Faza I)

1. Dokumentacioni ligjor

- Projekti për Fazën e I të QSUT, është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë Shqiptare 37% dhe Bankës së Keshillit të Europës CEB – 63% sipas Marrëveshjes së Kredës së lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës së Keshillit të Europës me referencë FP/1515 e ratifikuar me Ligjin nr.9412, datë 20.05.2005 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredës ndërmjet Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës së Keshillit të Europës për Projektin e Fazës së Parë të QSUT”.

Emri i Projektit	Objekti i Projektit	Njesia e Zbatimit të Projektit	Financuesit e Projektit	Vlera e Projektit
1. Faza e parë e masterplanit të QSUT	Ndërtimi i spitalit të Mjekësisë Interne	PIU	CEB 14 milionë USD Qeveria Shqiptare 7.4 milionë USD	21.4 milionë USD

- Kreda disbursohet me transhe disbursimi, të cilat vetëm kur amortizohet në masën 90%, mund të disbursohet transhi pasardhës. Deri më tani janë disbursuar 4 transhe.
Gjithsej disbursuar 10,145,000 Euro ekuivalente me 13,354,184 000 USD nga 14,000,000 USD, pra 95% e shumës së kredës. Shuma e mbetur e padisbursuar prej 645,816 USD është e pakontraktuar.
- Kontrata e zbatimit të punimeve civile është lidhur me firmën fituese INSO Sistemi për le Infrastruktura Sociale spa më 18/12/2006 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë INSO spa, për një shumë prej 14.9 milion Euro, për dy blloqe ndërtimi godina A (urgjencë, mjekësia interne, trauma), Godina B (godina teknologjike suport i godinës A) me një sipërfaqe totale ndërtimi A+B 15,500 metra katrorë, si dhe rruga lidhëse për devijimin e trafikut në pjesën e përparme të spitalit.
- Punimet për fillimin e punimeve nisen me ndërtimin e rrugës e cila do devijonte trafikun, për të mundësuar fillimin e punimeve në bllokun qendror A me datë 1 Prill 2007. Nderkohe që punimet për godinën B si rrjedhim i komplikacioneve me rrjetet eksituese të kalldajave, tynelëve nentokesore dhe pamjaftueshmërisë

se sipërfaqes se ndertimit te planifikuar ne projekt jane mundesuar vetem me date 23 Maj 2008.

- Firma zbatuese ka perfunduar punimet, gjithashtu testet per kolaudimin e projektit kane perfunduar. Spitali i eshte dorezuar Drejtorise Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane. Firma furnizuese per Paisjet Mjekesore (te financuara keto me buxhetin e shtetit ka perfunduar installimet).

II. Projekti i Spitalit të Përgjithshëm të Kavajës - ALB019

1. Dokumentacioni ligjor

- Projekti i Spitalit të Përgjithshëm të Kavajës është një projekt i cili financohet ne menyre te perbashket prej Qeverise shqiptare-10% dhe Bankes Islamike per Zhvillim(IDB)- 90% sipas Marreveshjes se Kredise se lidhur mes Keshillit te Ministrave te RSH dhe Bankes Islamike per Zhvillim me reference **ALB019** e ratifikuar me Ligjin nr.9394, date 12.05.2005 “Per ratifikimin e Marreveshjes se Kredise ndermjet Keshillit te Ministrave te RSH dhe Bankes Islamike per Zhvillim per projektin e Spitalit te Pergjithshem te Kavajes”.

Emri i Projektit	Objekti i Projektit	Njesia e Zbatimit te Projektit	Financuesi i Projektit	Vlera e Projektit afersisht
Projekti per Spitalin e Pergjithshem KAVAJE	Ndertimi dhe paisja i Spitalit te Kavajes	PIU	IDB 3.85 milion Dinare Islamike OPEC 2.42 milion USD Qeveria Shqiptare 0.65 milion USD	8.76 Milione USD

- Kontrata e zbatimit te punimeve civile eshte lidhur me firmen fituese K.D.K. Sh.p.k. më 27/06/2007 ndermjet Ministrise se Shendetesise dhe shoqerise K.D.K Shpk, Tirane, per nje shume prej 4,679,451.12 Dollarë Amerikanë.
- Përsa i përket Kredisë me IsDB-në, e cila mbulon pjesën ndërtimore të këtij spitali, punimet janë në përfundim dhe është disbursuar 95% e kontratës së ndërtimit. Por tashmë paralelisht me përfundimin e punimeve kërkohet të fillojnë procedurat e kolaudimit dhe testimeve të spitalit, të cilat shtrihen në një hark kohor prej 6 muajsh. Pritemi ne lidhje me Bashkine e Kavajes, persa i perket pikave te lidhjes me ujrat e bardha dhe te zeza. Propozimi i shpimit te nje pusi, po testohet dhe analizohet ne menyre periodike nga ana bakteriale nga Instituti i Shendetit Publik.
- Në lidhje me kredinë me ref.1053P të dhënë prej Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për një shumë prej 2,420,000.00 USD për financimin e pajisjeve

mjekësore dhe mobiljeve të spitalit të Kavajës, procedurat e prokurimit dhe të kontraktimit janë finalizuar dhe janë marre edhe miratimet si nga OFID ashtu edhe nga IsDB-ja. Lëvrimi i kësaj kredie bëhet në bllok, mbeshtetur në Kontratat e lidhura për të tre lotet përkatëse, dhe për këtë arsye deri më sot nuk është bërë asnjë disbursim nga kjo kredi. Aplikimet për Disbursim janë realizuar në masën 99.5 %. Lëvrimi dhe instalimi i paisjeve është bërë. Pritet fillimi i procedurës së kolaudimit të objektit dhe marrjes në dorezim nga Drejtoria Spitalore.

2. Grafiku i punimeve

Data e fillimit të punimeve :

08/10/2007.

Projekti do të finalizohet brenda vitit 2010.

III. Projekti i Spitalit të Përgjithshëm Durrës (Faza II) – ALB 018

1. Dokumentacioni ligjor

- Projekti për Fazën e II të Spitalit të Përgjithshëm Durrës është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë shqiptare dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB). Të gjitha komponentet e kësaj marrëveshje të Kredisë së lidhur me Këshillin të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim me referencë **ALB018** e ratifikuar me Ligjin nr.9234, datë 20.05.2004 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim për projektin e Fazës së II të Spitalit të Përgjithshëm të Durrësit”.

Emri i Projektit	Objekti i Projektit	Njesia e Zbatimit të Projektit	Financuesi i Projektit	Vlera e Projektit afersisht
Projekti për Fazën e Dytë të Spitalit të Përgjithshëm Durrës	Ndërtimi dhe paisja e Spitalit të Fazës së II Durrës	PIU	IDB 5.42 milion Dinare Islamike Qeveria Shqiptare 1.177 milion USD	8.23 milion USD

- Kontratat janë realizuar në masën 100%. Projekti është finalizuar dhe në Dhjetor 2009, punimet e ndërtimit janë kolauduar dhe janë marre në dorezim nga Drejtoria e Spitalit. Firmes ndërtuese i është bërë lëvrimi i masës prej 5% garanci punimesh.

2. Grafiku i punimeve

Data e fillimit të punimeve :

02/09/2005

% e punimeve që pritet të kryhen deri në 31/12/2008:
100%

3. Disbursimet

- a) nga Financimi i huaj gjithsej 7,017,119 USD ekuivalente me 4,651,528 Dinare Islamike.
- b) Shuma prej 756,700 Dinare Islamike e padisbursuar ekuivalente afersisht me 1.2 Milion USD nuk do të disbursohet, pasi projekti është realizuar brenda kostove fillestare

Keto dite mbas mbarimit të periudhës së kolaudimit, pritet Misioni i Bankesë Islamike për Zhvillim për finalizimin e Raportit Përfundimtar të projektit.

IV. Projekti i Ndertimit të Spitalit të Shkodrës (Faza III)

1. Dokumentacioni ligjor

- Projekti për Fazën e III të Spitalit Rajonal Shkoder, është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë Shqiptare 40% dhe Bankesë së Keshillit të Europës CEB – 60% sipas Marrëveshjes së Kredës së lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankesë së Keshillit të Europës me referencë FP/1385 add4 e ratifikuar me Ligjin nr.10 004, datë 9.10.2008 “Për ratifikimin e Marrëveshjes kuader të huasë ndërmjet Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankesë së Keshillit të Europës për financimin e projektit “Rehabilitimi i spitalit rajonal Shkoder – faza e tretë”.

Emri i Projektit	Objekti i Projektit	Njesia e Zbatimit të Projektit	Financuesit e Projektit	Vlera e Projektit
“Rehabilitimi i spitalit rajonal Shkoder – faza e tretë”.	Projekti synon vazhdimin e rehabilitimit të Spitalit të Shkodrës. Punët kryesore të planifikuara të fazës së tretë do të jenë: Përfundimi i realizimit të departamenteve dhe shërbimeve që përfshihen në Master Planin fillestar (Spitalit Pediatrik, Ndërtësës Ndërmjetëse dhe Ndërtimi i godinave të reja për Departamentin e Endoskopisë, Pavionit të pacientëve për sëmundje akute mendore, kuzhina, lavanderia, zgjerimi i mjediseve teknike); Ndërtimi i mjediseve të përshtatshme për pacientët kronikë të psikiatrisë gjatë vitit të parë të zbatimit; Integrimi i poliklinikës në zonën spitalore (me rreth 15-17 shërbime); Organizimi i një rrjedhe të logjikshme të punës; Përmirësimi i regjistrimit dhe menaxhimit.	PIU	CEB 6 milion Euro Qeveria Shqiptare 4.331 milion Euro CEB NTA grant 150,000 Euro	10.481 milion Euro

- Kredia disbursohet me transhe disbursimi, të cilat vetëm kur amortizohet në masën 90%, mund të disbursohet transhi pasardhës. Deri me tani është disbursuar 1 transh.

- **Gjithsej disbursuar 3,000,000 Euro, pra 50% e shumës së kredisë.**
- Kontrata e zbatimit të punimeve civile është lidhur me firmën fituese Esi Energia e Servizi Italia spa, për një sipërfaqe totale ndërtimi 15,500 metra katrorë (punime ndërtimi, punime elektrike dhe mekanike) dhe sistemim të ambienteve të jashtme. Përsa i përket financimit me kosto lokale prej 40%, kontraktori ka mëse 4 muaj që nuk paguhet nga fondet e buxhetit të shtetit.

2. Grafiku i punimeve

Data e fillimit të punimeve:
15/10/2009

% e punimeve që janë kryer deri në 30/10/2010:	53%
Afati i përfundimit të punimeve është:	Dhjetor 2011

V. Projekti “Rikonstruksioni dhe Pajisjet për 5 poliklinika

Bazuar në Ligjin Nr.9238 datë 10.06.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit Rehabilitimi dhe Pajisja e 5 Poliklinikave”, është akorduar një kredi e bute prej 5.080.000 euro, për të bërë të mundur të gjitha aktivitetet e projektimit, realizimit dhe monitorimit.

Objektivi i përgjithshëm

i programit është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përfutuese dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë kostot e menaxhimit të sistemit shëndetësor.

Rezultatet e pritshme të këtij programi:

- 5 Poliklinika të rehabilituara dhe të pajisura.
- Rritja e dhënies së shërbimeve me shumë se 50%.
- Përmirësimi I aktivitetëve mjekësorë të parandalimit me ulje të patologjive në fushën e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetit riprodhues dhe pediatrie.
- Gusht 2008 filluan punimet për ristrukturimin e Poliklinikës së qytetit të Korçës, të cilat kanë përfunduar është duke u kryer kolaudimi nga drejtorja e spitalit Korçë. Diferenca prej rreth 22.000 euro nga totali i kontratës së lidhur do të disbursohet me t’u dorëzuar proces-verbali i kolaudimit.
- Është zhvilluar në v.2009 gara me objekt: “Rikonstruksionin e Poliklinikave Gjirokaster dhe Diber”, me vlerë limit 611.475 euro, por që për arsye të mungesës së konkurrencës, kjo garë u anulua. Është ridërguar dokumentacioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për aprovim të botimit të lajmerimit të garës, duke pasqyruar dhe disa ndryshime të kerkuara nga kjo e fundit.

Gjithshka është gati për shpalljen e garave për « Furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve mjekësore dhe të mobilimit për poliklinikën e qytetit të Korçës, Tiranës » Gjithshtu është gati shpallja e garës për “Rikonstruksionin e

Poliklinikave Gjirokaster e Peshkopi. Pritet miratimi i dates se gares nga Ministria e Puneve te Jashtme _Rome.

Per ecurine e zbatimit te projektit eshte ngritur njesia e zbatimit te projektit

V. Projekti “Fuqizimi i Pergjigjes Kombetare te Shqiperise ndaj HIV/AIDS per grupet e Pambrojtura

VI. Projekti “Pershkallezimi i Pergjigjes Kombetare ndaj TB

Shqiperia nepermjet Institutit te Shendetit Publik aplikoi dhe fitoi ne Raundin e Peste te aplikimeve prane Fondit Global.Nepermjet VKM NR 705 dhe Nr.706 Dt, 18.10.2006 – “Per miratimin ne parim te marreveshjes se grantit, ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise ndaj Fondit Global, per programin “Fuqizimi i Pergjigjes Kombetare te Shqiperise ndaj HIV/AIDS per grupet e pambrojtura dhe programin “Pershkallezimi i Pergjigjes Kombetare ndaj TB- te dy grantet u bene efektive perkatesisht ne vlerat 4,936.229 USD dhe 1,263.490 USD.

Per shkak te performances pozitive te ecurise programtike dhe financiare te implementimit te granteve ne vitin 2009 ISHP dhe PIUGFTAM fituan te drejten e vazhdimit te fazes se dyte te projektit. Qeveria miratoi ne parim marreveshjet e grantit perkatesisht nepermjet VKM 765 DT 8.7.2009 dhe VKM 766 DT 8.7.2009. PIU eshte tashme ne implementimin e vitit te fundit te projektit.

- Persa i takon grantit te HIV, disbursimi i parashikuar per periudhen eshte 161. 532 USD dhe i realizuar eshte 234.420 USD.
- Persa i takon Grantit te TB, disbursimi i parashikuar per periudhen eshte 36.279 USD dhe i realizuar eshte 55. 666 USD.

Sa i takon indikatorëve kryesore te grantit HIV:

Parandalimi:	Target/Plan	Target/Fakt	Koment
Nr. Perdorues te drogave ne programet e reduktimit te demit	3000	3924	
Nr. Perdorues te drogave ne programin methadon	900	522	pa realizuar
Nr. Dhenes te sherbimit te trajnuar	701	1345	
Nr. Punonjese seksi ne programe parandalimi HIV	130	302	
Nr. Programe te punonjesve te seksit	2	2	
Nr. Meshkuj qe bejne seks me meshkuj ne programe te parandalimit HIV	550	919	

Nr. Per Edukatore me komunitetin ROM	175	628	
Nr. CONDOM te shperndare	350.000	370.941	
Nr. Perfituesish te Keshillim dhe Testim	4400	6696	
Nr. Qendra Keshillim dhe Testim	14	14	
Nr. Perfituesish te ARV TERAPI	130	140	
Nr, Roma me HIV parandalim	5800	5841	

Targeti i parealizuar deri me tani eshte NR. i perdoruesve qe jane ne programe methadone. ISHP dhe PIU po bejne perpjekje per te arritur kete indikator. Aksion + eshte e vetmja NGO qe sihuron kete sherbim. Qendra te reja kemi ngritur ne Durres, Elbasan, Korce, Vlore dhe Shkoder.

- Sa i takon indikatorëve kryesore të grantit TB:

PARANDALIMI	Target/Plan	Target/Fakt	Koment
Nr, Staf i trajnuar me DOTS	2520	2887	
Nr. i dispancerive dhe laboratoreve me mjaftueshmeri furnizimi me barna	100% (30)	100% (30)	
Nr i rasteve te reja me smear-positive qe trajtohen nen DOTS	84/ 122	73/110	
Nr i rasteve te reja me smear-positive qe trajtohen nen DOTS te trajtuar me sukses	89%	93.3%	
Nr i njesive shendetsore qe raportojne	100% (30)	100% (30)	
Nr i pacienteve te TB qe marrin keshillim per HIV	68	90	

Nuk jane verejtur problematika ne implementimin e granteve.

VII. Projektin "Forcimi i sistemit te emergjences ne spitalin Shkoder"- grant qeverise italiane

Objektivi i projektit

Reabilitimi ne spitalin e Shkodres te urgjences

- **Shenim** : Rezultate mbi disbursimet per kete projekt ne si institucion nuk disponojme.

Perpjektet nga ana e institucionit per to ka qene maksimale. Ne jemi drejtuar Minisstrise se Financave si dhe se fundmi Ambasades Italiane si autoritet i vetem i dhenies se informacionit por deri me sot nuk disponojme te dhena.

VIII. Projekti Zhvillimi i mjeksise transfuzionale ne Shqiperi sipas Standarteve te Cilesise Europiane

Projekti eshte nenshkruar ne 26.01.2006 nga Ministria e Puneve te Jashtme te Qeverise Italiane dhe Qeverise Shqiptare.

Projekti perfundon me 2010.

- Per palen italiane projekti realizohet nepermjet ESTM (shkolla europiane mjeksise transfuzionale) dhe Departamentit te Planifikimit spitalor ne Ministrine e Shendetesise.

Bashkepunimi per realizimin e projektit arrihet nepermjet :

Binjakezimit te kater qendrave transfuzionale te gjakut ne shqiperi me qendra te njejta ne itali

Qendrat e distinuara per binjakezim ne shqiperi jane QKTGJ-ja dhe qendrat rajonale.

Objekti i projektit Zhvillimi i mjeksise transfuzionale ne Shqiperi sipas Standarteve te Cilesise Europiane

- **Shenim** : Rezultate mbi disbursimet per kete projekt ne si institucion nuk disponojme.

Perpjektet nga ana e institucionit per to ka qene maksimale. Ne jemi drejtuar Minisstrise se Financave si dhe se fundmi Ambasades Italiane si autoritet i vetem i dhenies se informacionit por deri me sot ne nuk disponojme te dhenaShenim

IX . Projekti Permiresimi i qendres se djegjeve te renda ne QSUT dhe mbeshtetja e aktiviteve te kesaj qendre per 12 muaj

Kontrata u nenshkrua ne ne 20 nendor 2008, grand midis QSUT dhe Komisionit European. Financimi eshte realizuar nepermjet Programit te Fqinjesise Itali-Shqiperi me nje vlere 950.000 euro (100% financim nga asistenca komunitare) Eshte pjese Programit « CARDS 2005 »

Objektiva e projektit

- Permiresimi i qendres se djegjeve te renda ne QSUT dhe mbeshtetja e aktiviteve te kesaj qendre per 12 muaj.

Nuk ka zhvillime te reja. Ndryshimi i dejtuesve te ketij institucioni ka sjelle ndryshime ne stafin e drejtimit te projektit. Kjo ka veshtiresuar marjen e te dhenave.

X. Projekti Modernizimi i Sistemit Shendetesor ne Shqiperi

Ne shtator te vitit 2006, ka nisur implementimi i projektit te trete te Bankes Boterore, per sektorin e shendetesise: “ Modernizimi i Sistemit Shendetesor ne Shqiperi” , i financuar nga Shoqata Nderkombetare per Zhvillim (IDA) si dhe me bashkefinancim nga Qeveria Japoneze ne formen e nje granti. Kostoja e pergjithshme e ketij projekti te rendesishem per sektorin eshte perlllogaritur te jete afersisht 17 milion USD nga te cilat financimi nga IDA parashikohet te jete 15,4 milion USD, kontributi nga Qeveria Japoneze te jete 1,6 milion USD si dhe kontributi i Qeverise Shqiptare per projektin te jete 2,4 milion USD. Afati perfundimtar i implementimit te projektit eshte shtyre deri me 30 Mars 2012.

Objektivat kryesore te ketij projekti jane: (i) permiresimi i aksesit fizik dhe finciar si dhe perdorimi i sherbimeve shendetesore paresore te cilesise se larte; (ii) permiresimi i kapaciteteve kombetare per te formuluar, zbatuar politika dhe reforma shendetesore ne sektorin e shendetesise si dhe (iii) permiresimi i administrimit dhe menaxhimit te spitaleve..

Ne funksion te realizimit te ketyre objektivave, ky projekt eshte parashikuar te kete tre komponente kryesore. Ne vijim te ketyre komponenteve gjithashtu jane percaktuar dhe aktivitetet kryesore.

A. Ndertimi i kapaciteteve per sigurimin e sherbimeve shendetesore ne Institutin e Sigurimeve Shendetesore si dhe ne Institutin e Shendetit Publik do te perfshije aktivite te tilla si: (1) zhvillimi i metodave te pageses dhe kontraktimit ndermjet bleresit dhe ofruesit te sherbimeve shendetesore; (2) zhvillimi dhe monitorimi i politikave dhe strategjive shendetesore per MSH dhe ISHP; (3) krijimi dhe menaxhimi i sistemeve shendetesore te informacionit; (4) krijimi i nje sistemi monitorimi te sherbimeve te kujdesit shendetesor; (5) pergatitja e standarteve per licencimin e punonjeseve te shendetesise dhe spitaleve; (6) zhvillimi i kapaciteteve per vlersimin e teknologjive shendetesore si dhe pergatitja e standarteve per pajisjet dhe mbeshtetjen e sistemeve spitalore; (7) ndertimi i kapaciteteve ne MSH per zbatimin dhe administrimin e ketij projekti.

B. Permiresimi i ofrimit te sherbimeve shendetesore te kujdesit paresor synon zbatimin e reformave institucionale dhe te investimeve me qellim permiresimin e aksesit dhe cilesise se ketyre sherbimeve. Nder aktivitetet kryesore, te cilat synojne permbushjen e objektivave te mesiperme, mund te permendim: (1) lehtesimi i procesit te regjistrimit te popullsise per te marre sherbime shendetesore te kujdesit paresor; (2) ndertimi i kapaciteteve te menaxhimit prane ketyre sherbimeve (3) pergatitja e Guidave Klinike; (4) krijimi i sistemit te edukimit te vazhdueshem mjekesor;(5) zhvillimi i programeve te trainimit per mjeket; (6) sigurimi i pajisjeve baze shendetesore per sherbimin e kujdesit shendetesor paresor (7) organizimi i fushatave te informacionit publik per te nxitur regjistrimin e perfitueseve te sherbimeve.

C. Përmirësimi i menaxhimit dhe administrimit të spitaleve do të synojë ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të spitaleve nëpërmjet : (1) forcimit të

meaxhimit financiar, menaxhimit të përgjithshëm dhe kapacitetit të prokurimit në spitale; (2) zhvillimit të një kuadri rregullator, duke përfshirë urdhëresat dhe rregulloret për të lehtësuar ndryshimin e statusit të spitaleve në ente autonome publike dhe zhvillimi i një strategjie spitalore racionalizimi si dhe (3) testimit të një modeli pilot për autonominë e spitaleve.

Ky projekt do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, në përmirësimin e aksesit fizik ndaj këtyre shërbimeve, në përmirësimin e kapaciteteve për administrim dhe menaxhim nëpërmjet informatizimit të sistemit shëndetësor, pajisjes së të gjitha njësive shëndetësore që i perkasin kujdesit shëndetësor parësor me pajisje bazë si dhe me hartimin dhe vënien në zbatim të guidave klinike.

Deri më tani, në kuadër të këtij projekti vlen për tu përmendur që të gjitha aktivitetet e parashikuara për tu financuar nga Qeveria Japoneze në kuadër të një granti i cili është pjesë integrale e këtij projekti, kanë përfunduar në masën **82%**. Pas rishikimit afat mesëm të këtij projekti kanë përfunduar apo janë drejt përfundimit disa asistencat të rëndësishme teknike që priten të përfundojnë brenda këtij viti si asistencat teknike për hartimin dhe implementimin e llogarive kombëtare shëndetësore, asistencat teknike për të mbështetur nivelin e lartë menaxhues të spitaleve për implementimin e kuadrit të ri rregullator, asistencat teknike për të mbështetur ISKSH në ngritjen e kapaciteteve analitike si dhe asistencat teknike për të ngritur kapacitetet në sektorin e monitorimit dhe vlerësimit në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilat pa dyshim do shenojnë një impakt cilësor në tërë sistemin tonë shëndetësor.

Në vijim, në kuadër të aktiviteteve të parashikuara për tu financuar nga IDA, ka përfunduar implementimi i disa kontratave të asistencës teknike, objekt kryesor i të cilave kanë qenë: (i) rishikimi vjetor i performancës së sistemit shëndetësor dhe përlogaritja e kostos së nevojshme për implementimin e strategjisë shëndetësore; (ii) përgatitja e pesë udhërefyeseve kombëtare klinike për kujdesin shëndetësor parësor; (iii) përditesimi i indikatorëve të projektit të modernizimit të sistemit shëndetësor shqiptar dhe (iv) përgatitja e kuadrit rregullues për autonominë e ofruesëve të shërbimit dhe vlerësimi i projekteve pilot të spitalit të Durrësit dhe krijimit të ASHRT-s.

Bazur dhe në rishikimin afat mesëm të projektit kanë përfunduar brenda viti 2010 kontratat e tjera të asistencës teknike të cilat ka mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë si dhe Institutin e Sigurimeve Shëndetësore (i) rritjen e kapaciteteve ndërtuese në menaxhimin spitalor dhe financiar; (ii) kontraktimin e shërbimeve ndihmëse në spitalet rajonale; (iii) vlerësimin e teknologjive shëndetësore; (iv) licencimin dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore; (v) hartimin e strategjive të efektshme të komunikimit; (vi) përgatitjen e një master plani të përgjithshëm investimi,

Po kështu ka përfunduar blerja dhe shpërndarja e shtatë autoklavave dhe 4 mamografeve për spitalet rajonale. Ka përfunduar dhe procesi i kontraktimit për blerjen e pajisjeve kompjuterike për informatizimin e farmacive si dhe është drejt mbylljes procesi i tenderimit për blerjen e një pakete të rëndësishme me pajisje mjekësore për spitalet rajonale me vlerë 3 milion USD si dhe implementimi i data warehouse për ISHP me vlerë 500 mijë USD.

Si perfundim mund te thuhet se deri me tani, nga fondet e IDA-s jane kontraktuar dhe jane angazhur rreth 10 milion USD apo 70% e shumes se parashikuar. Ndersa nga fondet e Grantit japonez jane disbursuar 82% te tyre. Niveli i disbursimit eshte 52%.

Ne proces tenderimi jane dy kontrata asistence teknike qe kane te bejne me zhvillimin e nje plani te burimeve njerezore dhe me hartimin e metodave te pageses per te mbeshtetur reformen spitalore.

XI.Projekti Blerje pajisjeve mjeksore per Su 'Shefqet Ndroqi »

Kontrate eshte e lidhur midis Ministrise se Shendetesise te Republikes se Shqiperise (Bleresi) dhe AME International Austri perfaqesuar nga Z. Heinz Messinger Drejtor i pergjithshem (Shitesi).

Vlera e kontrates 7.488 milion Euro .

Kontrata e firmosur ne date 30.04.2009
Koha e realizimit te Kontrates 18 Muaj.
Kontrata eshte e perbere nga 34 artikuj,
Vlera e projektit eshte disbursuar plotesisht